



*Thënie
të
Profetit Muhamed a.s.
mbi
Virtytet e Larta*



أحاديث في الأخلاق - باللغة الألبانية



Conveying Islamic Message Society

P.O.Box 834 - Alex - Egypt

E-Mail: info_en@islamic-message.net

E-Mail: cims_eg@yahoo.com

Site: www.islamic-message.net

Not for sale *يُعهى ولا يُباع*

شبكة
الألوكة
www.alukah.net

أحاديث في الأخلاق - باللغة الألبانية

Thënie

të

Profetit Muhamëd a.s.

mbi

Virtytët e Larta

*Padyshim,
Allahu urdhëron
që të mbahet drejtësi,
dhe të bëhet bamirësi,
dhe të ndihmohet i afërmi,
dhe ndalon nga e keqja,
dhe nga ligësia,
dhe nga dhunimi,
Ai ju këshillon juve që ju të reflektoni*

(Nahl:90)

VLERAT E PËRGJITHSHME TË VIRTYTEVE TË LARTA

1- “Jam dërguar që të komplotoj virtytet e larta” (Maliku:1742 dhe Ahmedi:8952)

Shënim: Misioni i Profetit tonë a.s. ishte qe te çonte deri në fund punën e nisur nga profetët e mëhershëm. Të predikonte dhe të kompletonte virtytet e larta. Virtytet e larta fetare dhe morale. Ai e përmbushi këtë mision me devotshmëri dhe përkushtim. Ai ringjalli mësimet dhe porositë e harruara të Profetëve të mëhershëm, dhe korrigjoi shtrembërimet dhe shpifjet që kishin pësuar mësimet e Tyre përgjatë historisë. Ai meriton që të quhet• - në kuptimin e plotë të fjalës - edukatori dhe mësuesi më i madh ndonjëherë i vlerave dhe i virtyteve të larta.

2- “Padyshim që besimtari nëpërmjet sjelljes së mirë arrin gradën e atij që agjëron, e që falet (vullnetarisht)” (Ahmedi:25013 dhe Ebu Daudi:4798)

Shënim: Kjo thënie e Profetit a.s. na e bën me dije, që gradat e larta tek Zoti i Madhëruar, siç arrihen nëpërmjet adhurimeve vullnetare, poashtu arrihen edhe nëpërmjet sjelljes së mire.

3- “Besimtari që ka besimin më të plotë, ndër të gjithë besimtarët, është ai që ka sjellje më të mirë, dhe më të mirët në mesin e besimtarëve, janë ata që janë më të mirë me gratë e tyre” (Ahmedi:7402)

Shënim: Kjo thënie e Profetit a.s. na vë në dukje se sjellja e mire është pjesë e besimit, dhe se ai që e ka sjelljen më të mirë, e ka dhe besimin më të plotë. Dhe se, sjellja e mire duhet të fillojë që në familje, mes bashkëshortëve. Dhe se, besimtari nuk mund të jetë besimtar i mirë, apo i denjë, nëse nuk sillet mirë me bashkëshorten e tij.

4- “Nuk ka gjë, që peshon më shumë, në peshoren e besimtarit, në ditën e Kijametit, se sa sjellja e mirë” (Ahmedi:27517)

Shënim: Shpëtimi i besimtarit, në ditën e gjykimit, varet nga pesha e veprave të tij të mira. Me këtë thënie, Profeti a.s. na këshillon, që për të rënduar veprat tona të mira, dhe për të shtuar sa më shumë peshën e tyre, duhet që të përvetësojmë sjellje te mire, sepse sjellja e mire, peshon më shumë se ç’do gjë tjetër, veç obligimeve.

5- “Ata të cilët kanë sjellje më të mirë nga mesi juaj, do të jenë më të dashurit për mua, dhe do të jenë të pozicionuar më pranë meje në ditën e Kijametit” (Ahmedi:17732)

Shënim: Pozicionimi sa më pranë Profetit a.s. në ditën e Gjykimit si dhe fitimi i dashurisë së Tij është dëshirë e ç’do besimtari. Me këtë thënie Profeti a.s. na e bën me dije se një nga mënyrat për ta arritur këtë është përvetësimi i një sjellje sa më të mirë.

6- “ Më i dashuri ndër ju, për mua, është ai që ka sjellje më të mirë ” (Buhariu:3759)

Shënim: Për besimtarin e denjë, Profeti a.s. është njeriu më i dashur dhe më i shtrenjtë ndonjëherë. Ai do të ofronte gjithçka, në këmbim të dashurisë së Profetit a.s. dhe do të interesohej, për të ditur, se cila është mënyra, për të fituar dashurinë e Tij a.s. Nëpërmjet kësaj thënie, Profeti a.s. na tregon mënyrën, nëpërmjet të cilës, besimtari jo vetëm që fiton dashurinë e Profetit a.s. por bëhet njeriu më i dashur për të. Kjo mënyrë, është përvetësimi i sjelljes më të mirë.

MIRËSJELLJA ME TË TJERËT

7- “ Pasoje të keqen me të mirë, që ta fshijë atë, dhe trajtoji njerëzit me sjellje të mirë ” (Ahmedi:21988)

Shënim: Njeriu është i gabueshëm dhe i prirur për të bërë gabime. Përgjegjësia e tij është që të ruhet sa më shumë nga gabimet. Nëse ndodh që të gabojë, atëherë ai rekomandohet që menjëherë pas gabimit të bërë, të bëjë vepra të mira, pasiqë, veprat e mira shërbejnë për të fshirë gabimet e bëra. Nje nga veprat e mira qe sherben per te shlyer gabimet e bera eshte dhe sjellja e mire me njerezit.

8- “ Muslimani është ai, nga gjuha dhe dora e të cilit, njerëzit janë të sigurtë, dhe besimtari është ai, të cilit njerëzit i besojnë jetën dhe pasurinë e tyre ” (Ahmedi:8931)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie, Profeti a.s. na tregon se si duhet të jetë një musliman, dhe një besimtar i vërtetë. Muslimani dhe besimtari i vërtetë, i respekton të drejtat e të tjerëve. Ai nuk i lëndon njerëzit e pafajshëm, as me gjuhë e as me dorë. Ai, jo vetëm që nuk i cënon pronat dhe të drejtat e të tjerëve, por i ruan dhe i mbron ato nga agresorët.

9- “ Një person, i përmendi Profetit a.s. një grua, e cila shquhej që falej shumë, dhe që agjëronte shumë, dhe që jepte lëmoshë shumë, vetëm se, ajo i lëndonte fqinjët e saj me gjuhën e saj. Profeti a.s. tha: Ajo është për në Zjarr. Pastaj, personi i përmendi Profetit a.s. një grua tjetër, që falej pak, dhe agjëronte pak, dhe që jepte për lëmoshë copëzat e djathit, por nuk i lëndonte fqinjët e saj me gjuhën e saj. Ai tha: Ajo është për në Xhenet. (Ahmedi:9675)

Shënim: Besimtari ka dy lloje detyrimesh: Detyrime ndaj Zotit, dhe detyrime ndaj krijesave. Të dyja llojet e detyrimeve janë të domosdoshme. Për pasojë, ai që i përkushtohet përmbushjes së detyrimeve ndaj Zotit, dhe neglizhon detyrimet që ka ndaj krijesave, është mëkatar. Gjithashtu, ai që i përkushtohet përmbushjes së detyrimeve që ka ndaj krijesave, dhe neglizhon detyrimet që ka ndaj Zotit, është mëkatar. Besimtar i denjë, është ai i cili mundohet që t'i përmbushë të dyja llojet e detyrimeve.

Shënim: Me frazën “falej shumë, agjëronte shumë dhe jepte lëmoshë shumë” është për qëllim, që ajo, veç adhurimeve të detyrueshme, angazhohej shumë dhe me adhurime vullnetare. Ndërsa me frazën “falej pak, agjëronte pak” është për qëllim, që ajo, veç adhurimeve të detyrueshme, nuk angazhohej shumë me adhurime vullnetare.

10- Njëherë, Profeti a.s. i tha shokëve të Tij: A e dini se kush është i falimentuari? Ata thanë: I falimentuari në mesin tonë është ai që nuk posedon asnjë qindarkë dhe asnjë orendi. Profeti a.s. tha: I falimentuari i këtij umeti është ai i cili do të vijë në ditën e gjykimit me agjërim dhe me namaz dhe me lëmoshë, porse do të vijë ndërkohë që i ka prekur nderin dikujt, dhe i ka hedhur akuza të pabaza dikujt tjetër, dhe ka ngrënë padrejtësisht pasurinë e dikujt tjetër. Ai do të ulet, dhe ata të cilëve ai u ka bërë keq do të marrin të mirat e tij, nëse të mirat e tij mbarojnë ende pa u larë hesapet, atëherë do të merren gabimet e tyre dhe do t'i kalohen atij, dhe ai do të hidhet në Zjarr. (Ahmedi:8029)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie, Profeti a.s. na ndërgjegjëson që të tregohemi të kujdesshëm ndaj detyrimeve që kemi ndaj të tjerëve, dhe na paralajmëron që të mos i dëmtojmë ata, dhe të mos i shkelim të drejtat e tyre. Dëmtimi i të pafajshmit është mëkat i rëndë, shpagimi i të cilit është larja e hesapeve në ditën e Gjykimit.

MËSHIRA NDAJ TË TJERËVE

11- “ Nuk është prej nesh, ai i cili nuk mëshiron të vogëlin tanë, dhe nuk ia njeh meritat të madhit tanë” (Ahmedi:7073)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie, Profeti a.s. na sensibilizon që të tregohemi të mëshirshëm dhe të dashur me moshat e vogla, dhe të tregojmë respekt dhe vlerësim ndaj moshave të mëdha. Dhe se, ai që nuk tregon mëshirë ndaj të vegjëleve, apo respekt ndaj të mëdhenjve, nuk është përfaqësues i kulturës islame.

12- “ Allahu e ndau mëshirën në njëqind pjesë. Ai mbajti pranë Vetes nëntëdhjetë e nëntë pjesë. Ndërsa, një pjesë të vetme e lëshoi në Tokë, nëpërmjet të cilës, krijesat kanë mëshirë ndaj njëra tjetrës, saqë, kali e largon thundrën e tij, nga i vogli i tij, për të mos e lënduar atë” (Tr.Buhariu nr.6000 dhe Muslimi nr.2752. Tek Muslimi është “kafsha” në vend të “kali”)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie, Profeti a.s. na tregon për përmasat e mëdha të mëshirës së Allahut të Madhëruar, dhe se, një pjesë e mëshirës së Tij është lëshuar në këtë Tokë, falë të cilës, krijesat kanë mëshirë dhe dhembshuri ndaj njëra tjetrës. Ndërkohë, pjesa më e madhe e mëshirës së Tij është e rezervuar për njerëzit e mirë në Jetën e Përtejme, ku do të bashkohen të gjitha mëshirat.

13- “ Një ditë, teksa i Dërguari i Allahut ishte me disa shokë, vuri re një grua që po shtrëngonte fort në kraharorë foshnjën e saj. Në atë çast, Ai i tha shokëve të Tij: A mendoni se kjo grua e hedh foshnjën e saj në zjarr? Ata i thanë: Kurrë. Atëherë Ai tha: Allahu është më i mëshirshëm ndaj robërve të Tij se sa kjo ndaj fëmijës së saj ” (Tr.Buhariu nr.5999 dhe Muslimi nr. 2754)

Shënim: Përmasat dhe dimensionet e mëshirës së Allahut të Madhëruar janë të papërshkrueshme. Askush nuk është i aftë që të përcaktojë kufinjtë e mëshirës së Tij. Nga të gjitha krijesat, nëna është krijesa më e mëshirshme, në veçanti, ndaj të voglit të saj. Ndërsa foshnja është krijesa më e dhembshur, ndër të gjitha krijesat. Profeti a.s. na bën me dije se Allahu i Madhëruar është akoma më i mëshirshëm ndaj robërve të Tij se sa krijesa më e mëshirshme, nëna, ndaj krijesës më të dhembshur, foshnjes.

14- “ Po ta dijë besimtarë se çfarë dënimë ka tek Allahu, askush nuk do të shpresonte për Xhenetin e Tij, dhe po ta dijë jobesimtarë se çfarë mëshire ka tek Allahu, askush nuk do të humbte shpresë për Xhenetin e Tij ” (Muslimi nr.2755)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. e ndërgjegjëson besimtarin e denjë dhe e paralajmëron atë që të mos i hyjë vetja në qejf dhe të mos bëhet mendjemadh për virtytet që ka. Njëkohësisht, ai e ndërgjegjëson jobesimtarin që të heqë dorë nga mosbesimi dhe mëkatet, dhe të shpresojë për faljen dhe mëshirën e Zotit, sepse mëshira e Tij nuk njihet kufij.

15- “ Të mëshirshmit do të mëshirohen nga i Gjithëmëshirshmi. Kini mëshirë ndaj atyre që janë në Tokë, që të ketë mëshirë ndaj jush Ai që është në Qiell ” (Tr. Ahmedi nr.6494 dhe Ebu Daudi nr.4941 dhe Tirmidhiu nr.1924)

Shënim: Kjo është një thënie shumë sensibilizuese dhe shumë madhështore. Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na edukon që të tregojmë mëshirë ndaj krijesave që jetojnë rreth nesh. Dhe bën me dije se mëshirën e Zotit do ta gëzojnë vetëm ata që janë të mëshirshëm me krijesat e Tij.

16- “ Allahu nuk do të ketë mëshirë ndaj atij që nuk ka mëshirë ndaj njerëzve ” (Tr.Buhariu nr.7376 dhe Muslimi nr.2319)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. i paralajmëron të gjithë ata që nuk kanë mëshirë ndaj të tjerëve se do të privohen nga mëshira e Allahut të Madhëruar në ditën kur ata më shumë se kurrë do të kenë nevojë për mëshirën e Tij.

17- “ Allahu do të ketë mëshirë, vetëm ndaj atyre që kanë mëshirë ” (Tr.Buhariu nr.7448 dhe Muslimi nr.923)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. i përgëzon të gjithë ata që kanë mëshirë për të tjerët se do të përfshihen në mëshirën e Allahut të Madhëruar në ditën e madhe të gjykimit. Njëkohësisht, ai na e bën me dije se mëshira e Tij në ditën e gjykimit do të jetë ekskluzivisht për të mëshirshmit.

18- “ I pamëshirëshëm është vetëm i ligu ” (Tr. Ahmedi nr.8001 dhe Ebu Daudi nr.4942 dhe Tirmidhiu nr.1924)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na e bën me dije se njeriu i mirë dhe fisnik është gjithmonë i mëshirshëm. Ndërsa, i pamëshirshëm është vetëm njeriu i ligë dhe i ulët.

19- “ Teksa, një burrë po ecte, e zuri një etje e madhe. Ai gjeti një pus, dhe zbriti në të, dhe piu ujë. Kur doli nga pusi, pa një qen të etur, i cili po lëpinte dheun nga etja. Ai tha me vete: Ky qen po vuan nga etja siç po vuaja unë pak më parë. Atëherë, ai u fut edhe një herë në pus, dhe mbushi opingën e tij me ujë, dhe e mbajti atë me gojë derisa u ngjit, dhe i dha ujë qenit. Allahu i Madhëruar e vlerësoi shumë gjestin e tij, dhe si rrjedhojë, ia fali atij mëkatet. Të pranishmit thanë: A kemi shpërblim për kafshët o Profet i Allahut? Ai tha: Për çdo gjë të gjallë ka shpërblim ”
 (Buhariu nr.2363 dhe Muslimi nr.2244.Ndërsa në një version tjetër të Buhariut dhe Muslimit transmetohet e njëjta gjë por,për një femër të pamoralshme nga beni israilët)

Shënim: Nëpërmjet këtij tregimi Profeti a.s. na sensibilizon që të jemi sa më humanë dhe sa më bamirës, jo vetëm ndaj njëri tjetrit, por edhe ndaj krijesave të tjera, veç llojit tonë. Dhe se humanizmi dhe bamirësia kundrejt krijesave është një gjest fisnik, që çmohet shumë shtrenjtë nga Allahu i Madhëruar.

20- “ Një grua hyri në Zjarr ngaqë e mbajti një mace të lidhur, as nuk i dha të hante, por as nuk e la të hante nga insektet e Tokës ” (Buhariu nr.3318 dhe Muslimi nr.2242)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na ndërgjegjëson që dhuna është një ligësi që urrehet tejmas nga Allahu i Madhëruar. Kushdo që ushtron dhunë ndaj një të pafajshmi qoftë ai njeri apo çfarëdo krijese tjetër, do të përballlet me drejtësinë e Zotit në ditën e Gjykimit dhe do ta paguajë shtrenjtë.

21- “ Kini frikë Allahun për këto kafshë, hipni mbi to, sa janë të shëndetshme, dhe therini sa janë të shëndosha ” (Ahmedi nr.17625)

Shënim: Profeti a.s. ishte dërguar mëshirë për mbarë krijesat. Ai na ka edukuar që të tregohemi të mëshirshëm ndaj kafshëve të transportit, të cilat, Allahu i Madhëruar na i ka nënshtruar për të kryer nevojat tona, pa të cilat, njeriu do e kishte mjaftë të vështirë t'i kryente nevojat e tij. Nëpërmjet kësaj thënie ai na ndërgjegjëson që të kemi mëshirë ndaj kafshëve të transportit, të mos i ngarkojmë ato duke qenë të dobëta apo të sëmura, ngase një gjë e tillë i mundon dhe i lodh ato.

22- Njëherë Profeti a.s. hyri në një kopësht në të cilin ndodhej një deve. Me ta parë Profetin a.s. deveja u përlot dhe nisi të qajë me zë. Atëherë, Profeti a.s. iu afrua dhe i vuri dorën mbi qafë dhe ajo u qetësua. Pastaj, Profeti a.s. tha: Kush është pronari i kësaj deveje? Një djalë nga Ensarët tha: Unë jam, o Profet i Allahut. Atëherë, Profeti a.s. i tha: A nuk i frikësohesh Allahut për këtë kafshë që ta ka lënë ty në pronësi? Ajo mu ankua mua që ti e len të uritur dhe e mandon me punë të rënda” (Ebu Daudi nr.2549)

Shënim: Kjo ngjarje është një nga mrekullitë e shumta të Profetit tonë a.s. ndër të cilat mund të veçojmë këtu edhe: Ndarja e hënës në dy pjesë dhe bashkimi i saj, në prani të një grupi jobesimtarësh. Vajtimi i i trungut të palmës më zë të lartë, në prani të besimtarëve, në kohën kur Ai e ndërpreu predikimin tek trungu i palmës dhe kaloi tek minberi. Begatia në ujë dhe ushqim të pakët, nga i cili shuanin etjen dhe urinë një numër i madh njerëzish...etj.

23- “ Kinqi kujdes, mos i trajtoni kafshët tuaja si mrimber (d.m.th.mos bisedoni hipur mbi to, duke qëndruar në vend), sepse Allahu i Madhëruar ua ka nënshtruar juve ato, që t’iu çojnë në vende ku ju nuk mund të shkonit, vetëm se me mundim të madh. Ndërkohë, Ai u ka vënë në dispozicion juve Tokën, në të kryjeni nevojën tuaj ” (d.m.th. zbrisni në Tokë dhe bisedoni). (Ebu Daudi nr.2567)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. i sensibilizon njerëzit e asaj kohe të cilët i përdornin kafshët si mjet transporti, që të tregohen të mëshirshëm ndaj tyre. Dhe të mos qëndrojnë hipur mbi to, në kohën që kanë ndaluar, por të zbresin prej tyre, në mënyrë që edhe ato të mund të çlodhen.

24- “ Një milingonë pickoi njërin nga Profetët, dhe Ai dha urdhër që të digjej e tërë çerdhja e milingonave. Atëherë Allahu i shpalli Atij: Të pickoi një milingonë e vetme ndërsa ti dogje një çerdhe të tërë që më madhëronte Mua ” (Buhariu nr.3019 dhe Muslimi nr.2241. Në një version të Muslimit thuhet:Përse nuk dogje një të vetme?)

Shënim: Njëpërmjet kësaj ngjarje Profeti a.s. na tërheq vëmendjen që të mos dëmtojmë të pafajshmin për shkak të fajit të dikujt tjetër. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar thotë: “ Asnjë mëkatar nuk do të paguaj për mëkatin e tjetrit “

BUTËSIA

25- “ Allahu është i butë dhe e pëlqen butësinë, dhe Ai dhuron njëpërmjet butësisë atë që nuk dhuron njëpërmjet ashpërsisë, apo njëpërmjet ç’do gjëje tjetër të mundshme ” (Muslimi nr.2593)

Shënim: Butësia është një nga virtytet më të larta dhe më fisnike. Një besimtari të denjë nuk mund t’i mungojë butësia. Njëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na edukon që

ta stolisim karakterin tonë me virtytin e butësisë, pasi që, butësia është atribut i Allahut të Madhëruar, dhe është ndër virtytet që Ai e pëlqen më së shumti. Dhe se butësia është më e sukseshme në zgjidhjen e problemeve se sa ashpërsia.

26- “ Atij që i mungon butësia i mungojnë të gjitha të mirat ” (Muslimi nr.5292)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. i sensibilizon besimtarët që ta përvetësojnë virtytin e butësisë në jetën e tyre, ngase butësia është çelësi i mirësive dhe është mënyra më e goditur dhe më e sukseshme për arritjen e objektivave. Ai i cili i privon vetes së tij virtytin e butësisë, ai është i destinuar që të privohet nga mirësitë.

27- “ Butësia e zbukuron atë tek i cili gjendet, dhe e shëmtton atë tek i cili mungon ” (Muslimi:2593)

Shënim: Në këtë thënie, Profeti a.s. e përngjason virtytin e butësisë me stolinë, e cila e zbukuron atë që e vendos atë në trupin e tij. Në të njëjtën mënyrë, butësia e zbukuron dhe e hijeshon moralin e atij që e përvetëson atë. Ndërsa, mungesën e butësisë Profeti a.s. e konsideron si diçka që e shëmtton pamjen apo moralin e njeriut.

28-“ Nëse Allahu i dëshiron të mirën një familjeje, atëherë Ai ia mundëson atyre që të përvetesojnë virtytin e butësisë ” (Ahmedi:24734)

Shënim: Butësia është çelësi për një familje sa më të shëndoshë dhe sa më të lumtur. Nëpërmjet kësaj thënie, Profeti a.s. e sensibilizon familjen besimtare, që ta kultivojnë në gjirin e tyre virtytin e butësisë. Të mundohen që ti zgjidhin mosmarrëveshjet që lindin mes tyre me butësi dhe mirëkuptim. Nëse një familje, arrinë që t'i zgjidhë mosmarrëveshjet mes pjesëtarëve të saj, me butësi, atëherë kjo është një tregues, se Allahu i Madhëruar dëshiron që t'i begatojë dhe t'u japë atyre mirësi.

29- “ Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos tmerroni ” (Buhariu:69 dhe Muslimi:1732)

Shënim: Një nga synimet më themelore të fesë islame është lehtësimi i çështjeve, dhe zbutja e vështirësive ndaj besimtarëve. Zoti i Madhëruar nëpërmjet ligjeve dhe disiplinës që ka vendosur nuk synon që t'i mundojë njerëzit, por synon që t'i edukojë dhe t'i disiplinojë ata, dhe t'i pastrojë nga mëkatet dhe ligësitë. Legjislacioni islam përmban nene të posaçme ku parashikohen lehtësime për këdo që përballet me vështirësi apo me mundim të mirëfilltë dhe serioz. Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na porosit që t'i marrim në konsideratë lehtësimet që parashikon legjislacioni islam ndaj atyre që përballen me vështirësi serioze, në mënyrë që të dalin nga situata e vështirë dhe të mos dëmtohen.

TOLERANCA

30- “ Besimtari është miqësor, nuk ka mirësi tek ai i cili nuk është miqësor me të tjerët, dhe as të tjerët nuk janë miqësorë me të ”
(Ahmedi:9198)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na tregon se si duhet të jetë besimtari në raport me të tjerët. Ai thotë që besimtari duhet të jetë miqësorë dhe i afrueshëm me të tjerët, dhe nuk duhet të jetë i largët dhe armiqësor.

31- “Jam dërguar me fe të pastër, tolerante”
(Ahmedi:24855)

Shënim: Feja islame është fe monoteiste. Është e vetmja fe që është -në kuptimin e plotë të fjalës-e pastër nga politeizmi dhe nga besimet bestytnore. Njëkohësisht, feja islame është fe tolerante, në të, ka tolerancë për besimtarët, për të plotësuar nevojat dhe kënaqësitë e tyre, në të, ka lehtësime për ata që përballen me vështirësi dhe mundime serioze.

32- “ E mëshiroftë Allahu atë person, i cili është tolerant kur shet, kur blen, dhe kur kërkon të drejtën e tij ” (Buhariu:2076)

Shënim: Me këtë thënie Profeti a.s. na sensibilizon që të jemi sa më tolerantë në marrëdhënie me të tjerët. Të mos shohim vetëm interesin tonë personal, por të mendojmë edhe për të tjerët, për t’ia lehtësuar sadopak atyre hallet dhe nevojat që kanë.

33- “ Një personi, nga ata që kanë jetuar më parë, i morën engjëjt shpirtin, dhe i thanë: A ke bërë ndonjë vepër të mirë? Tha: Jo. I thanë: Pa, mendohu njëherë. Ai tha: I jepja njerëzve borxh, dhe i thosha djemve të mi që t’ia zgjatnin afatin e shlyerjes atij që nuk i posedonte të hollat, dhe që ta toleronin atë që kishte mirëqenie. Allahu i tha engjëjve: Toleroheni atë.” (Muslimi:1560)

Shënim: Kjo ngjarje nxjerr në pah rëndësinë e veçantë dhe vlerën e madhe të tolerancës. Ai besimtar i cili i ka toleruar të tjerët për të drejtat e tij, shpresohet që Allahu i Madhëruar ta tolerojë atë dhe t’i falë gabimet dhe mëkatet që ka bërë.

34- “ Ai, që ia shtyen nevojtarit, afatin e shlyerjes së borxhit, ose ia fal atij atë, në ditën e Gjykimit, Allahu i Madhëruar, do ta strehojë në hijen e Arshit të Tij ” (Ahmed:8711)

Shënim: Me këtë thënie, Profeti a.s. na sensibilizon që të solidarizohemi me njerëzit në nevojë, dhe t'i ndihmojmë ata për të dalur nga situata, duke ua lehtësuar dhe duke ua minimizuar atyre nevojat dhe hallet që kanë. Një mënyrë solidarizimi me njerëzit në nevojë është dhe toleranca ndaj borxhlinjëve, duke ua zgjatur atyre afatin e shlyerjes së borxhit, nëse nuk e kanë të mundur që ta shlyejnë atë në kohë, ose falja e borxhit, nëse janë të skamur.

35- “ Besimtari i cili përzihet me njerëzit dhe i duron shqetësimet që ata i shkaktojnë e ka shpërblimin më të madh se sa ai i cili nuk përzihet me ta dhe nuk i duron shqetësimet që ata i shkaktojnë ” (Ahmedi:5022)

Shënim: Me këtë thënie, Profeti a.s. e nxit besimtarin që të jetë sa më shoqëror dhe sa më i angazhuar në projektet dhe hallet e shoqërisë. Është e vërtetë që të qenurit shoqëror dhe i angazhuar në problemet e shoqërisë e ekspozon njeriun ndaj pakënaqësive dhe ndaj shqetësimeve të ndryshme, mirëpo Profeti a.s. na ndërgjegjëson që të mos ndahemi nga shoqëria, por të jemi pjesë e saj, duke

kontribuar për përmirësimin e problemeve të saj, dhe duke u angazhuar në kurimin e plagëve morale dhe ekonomike nga të cilat ajo vuan.

36- “ Tolero që të tolerohesh ” (Ahmedi:2233)

Shënim: Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na e bën me dije se njeriu do të trajtohet ashtu siç ka trajtuar ai të tjerët. Nëse, ai ka qenë i mëshirshëm ndaj të tjerëve, edhe Zoti do të jetë i mëshirshëm ndaj tij, nëse ai ka qenë i butë me të tjerët edhe Zoti do të jetë i butë me të, nëse ai i ka toleruar të tjerët, për të drejtat e tij, atëherë, edhe Zoti do ta tolerojë atë për gabimet dhe të metat që ai do të ketë.

DASHAMIRËSIA

37- “ Feja është dashamiresi (përzemërsi)” (Muslimi:55)

Shënim: Njëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s. na vë në dukje vlerën e dashamiresise dhe te përzemërsisë. Të jesh fetar do të thotë të jesh i dashamires dhe i përzemërt ndaj të tjerëve. Të jeshë i përzemërt ndaj Zotit të Madhëruar, duke e besuar dhe duke e adhuruar Atë me pastërti. Të jeshë i përzemërt ndaj ligjeve të Tij, duke ia vënë synim vetes përmbushjen dhe zbatimin e tyre. Të jeshë i përzemërt ndaj Profetit a.s. duke ia vënë synim vetes bindjen ndaj Tij dhe përmbushjen e porosive dhe mësimëve të Tij. Të jeshë i përzemërt ndaj udhëheqësve të muslimanëve, duke i respektuar ata dhe duke iu bindur atyre në çështjet e ligjshme, dhe duke i këshilluar ata me përzemërsi në rast se gabojnë. Dhe të jeshë i përzemërt ndaj besimtarëve në përgjithësi, duke ushqyer dashuri dhe respekt ndaj tyre, dhe duke i këshilluar me përzemërsi në rast se bëjnë gabime.

38- “ Askush prej jush nuk është besimtar derisa të dëshirojë për vëllain e tij atë që dëshiron për veten e vet ” (Buhari:13 dhe Muslimi:41)

Shënim: Më këtë thënie Profeti a.s. i sensibilizon besimtarët që të jenë dashamirës të njëri tjetrit. T'i duan të mirën njëri tjetrit. T'a ndihmojnë njëri tjetrin në rast nevojë. Të jenë të singertë dhe të përzemërt me njëri tjetrin.

39- “ Asnjë të mirë mos e përçmo, edhe sikur të takohesh me vëllain tënd me fytyrë të qeshur ” (Muslimi:2626)

Shënim: Me këtë thënie Profeti a.s. i sensibilizon besimtarët që t'i çmojnë dhe t'i vlerësojnë virtytet dhe veprat e mira. Sado i thjeshtë, qoftë virtyti, apo vepra e mirë, asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar. Sepse, çdo virtyt dhe ç'do vepër e mirë ka rezultatet e saj pozitive. Ndër veprat e mira të thjeshta, është dhe buzëqeshja ndaj vëllezërve, e cila shërben për të shprehur dashurinë dhe respektin ndaj tyre.

40- “ Ai që na mashtron nuk është prej nesh” (Muslimi:101)

Shënim: Mashtrimi është ligësi dhe mëkat i rëndë. Besimtari është i detyruar që ta mbajë veten të pastër nga kjo ligësi e urryer. Nëpërmjet kësaj thënie Profeti a.s.na e bën me dije që mashtruesi nuk ka lidhje me muslimanët dhe nuk i përfaqëson ata, ngase mashtrimi nuk ka vend në edukatën dhe kulturën islame.

Perzgjedhi dhe pershtati:
Rexhep Milaqi

هذا الكتاب منشور في

